



Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis

Datë 15.09.2023

Numri i vrojtimit i lejes:

07Nr.727/350-45911

Në bazë të nenit 21 të LPH nr.04/L-174 datë 31.07.2013, nenit 18 të LN nr.04/L-110 datë 31.05.2012, neni 13 paragrafi 4 pika 2 i UA-06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për Kushte ndërtimore, Leje ndërtimore dhe Leje rrënimi për kategorinë e I dhe të II të ndërtimeve, UA Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor datë 09.06.2017, Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, si dhe neneve 44,47,48 dhe 125 të LPPA nr.05/L-031, DUP në Suharekë lëshon këtë:

AKTVENDIM
(MBI LEJEN NDËRTIMORE)

Ky dokument lëshohet për:

Emri:	Drejtoria e Arsimit ne Komunën e Suharekës, me përfaqësues Remzi Bajselmani	Adresa:	Rruga "Brigada 123", Komuna e Suharekës-Suharekë
Email:		Kërkesa Bazë:	Leje Ndërtimore
Tel:		07N.350-45911 datë 24.07.2023

Emri i Projektit:	"Ndërtimi i Sallës Sportive ShFMU Naum Veqilhaxhi Mohlan" P+0		
Emri i Projektuesit:	"ENGGROUP" Shpk		
Adresa:	Rr." Nebih Gashi", Prishtinë		
Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI, KATEGORIA II- Sallë e Edukatës Fizike			
Adresa: Rr." Fazli Kabashi", "2 Korriku" Mohlan			
Zona(t) Kadastrale: Suharekë	Nr. i parcelës kadastrale:	Përpjesa	Koordinatat e Objektivit - Shenimi (Piketimi)
Sipas çertifikatës me nr. të lëndes 3615/2023 datë 18.08.2023	1811-0 1810-0	1: 1501	Y= 7492263.278 X=4692427.112 Y= 7492281.840 X=4692424.465 Y= 7492276.710 X=4692388.489 Y= 7492258.148 X=4692391.136
Lloji i ndërtimit të propozuar:			
Objekt Arsimor- Sallë Sportive ShFMU Naum Veqilhaxhi Mohlan" P+0			
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:			
Kategoria II			
Gabariti	(36.34m' x 18.75m')	Etazhiteti:	(P+0)
Vija rregullative	Sipas Aktvendimit mbi Kushte Ndërtimore: 07Nr.598/350-43964 datë 20.07.2023	Vija ndërtimore	Sipas Aktvendimit mbi Kushte Ndërtimore: 07Nr.598/350-43964 datë 20.07.2023

Përshkrimi i lejës ndërtimore

Me këtë vendim, parashtruesit të kërkesës Drejtoria e Arsimit në Komunën e Suharekës, me përfaqësues Remzi Bajselmani, i lejohet ndërtimi i objektit me destinim Sallë e Edukatës Fizike në parcelat kadastrale 1811-0 dhe 1810-0 ZK Mohlan pronë e Komuna e Suharekës sipas çertifikatës së pronës me Nr.3615/2023 datë 18.08.2023. Duke mos e tejkaluar koeficientin e ndërtimit dhe kushtet tjera të definuara me Hartën Zonale të Komunës, Kushteve ndërtimore dhe Udhëzimeve Administrative. Parcela ndërtimore e planifikuar me HZK është ndërtimore të planifikuar me HZK është Arsim dhe hapësira sportive ZSH4.

Objekti ka gabarit (36.34m' x 18.75m') me sipërfaqe bruto të objektit ~ 682.00 m², me etazhitet (P+0).

Ndërtimi i objektit të bëhet konform Kushteve Ndërtimore të lëshuara nga ky organ: 07Nr.598/350-43964 datë 20.07.2023 si dhe projektit kryesor hartuar nga byroja projektuese: "ENGGROUP" Shpk, Prishtinë.

Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi do të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ.

Poseduesi i Lejës Ndërtimore është i obliguar që:

- Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin.
- Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejën Ndërtimore;
 - Informata mbi Projektuesin;
 - Informata mbi Kontraktuesin;
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit.
- Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit;
 - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
 - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevoja të realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin e ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur;
 - Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për çertifikatë të përdorimit'
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit në shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore.
 - Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejës Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi;
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi;

- Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, investitori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftojë organet komunale.
- Obligohet investitori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njejtin ta transportojë në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
- Pas përfundimit të punëve ndërtimore, të aplikojë për certifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

Arsyetim

Aplikuesi Drejtoria e Arsimit ne Komunën e Suharekës, me përfaqësues Remzi Bajselmani, përmes kërkesës 07Nr.350-45911 datë: 24.07.2023, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejës Ndërtimore për ndërtim të objektit edukativo-Arsimor; Sallë Sportive, sipas projektit të bashkangjitur.

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Aktvendimi mbi Kushtet Ndërtimore 07Nr.598/350-43964 datë 20.07.2023
- Pëlqim për largimin e mbeturinave Nr.147/23, të datës: 25.05.2023, lëshuar nga NPRM "ECO-REGJIONI"- Prizren, Njësia operative Suharekë.
- Pëlqim për kyqje në rrjetin publik të Ujësjellësit dhe Kanalizimit –Hidroregjioni Jugor Prizren Nr.71, datë: 26.05.2023.
- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor – nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09 Nr.307, datë: 24.07.2023.
- Pëlqim me kushte për rregullimin e dokumentacionit teknik nga KEDS, Nr. 428, datë: 04.06.2023.
- Pëlqim për mbrojtje nga zjarri Nr.03/03-115, datë 14.09.2023.
- Koordinatat e objektit të vendosura sipas kushteve ndërtimore nga gjeodetet Komunës së Suharekës.
- Elaboratin për mbrojtje nga Zjarri tri kopje.
- Tri kopje të projektit zbatues.
- Kopje e planit dhe certifikata e pronësisë.
- Kopje e dokumentit identifikues.

Në bazë të nenit 8.14 Dispozitat e veqanta të rregullorës (dispozita lehtësuese) mbi tarifrat dhe ngarkesat, nuk do të paguhet taksë në këtë rast konform nenit 8.14.2 për objektet Arsimore, të rregullorës Nr-16-12102 të datës 01.12.2015, andaj edhe ky objekt lirohet nga pagesa e taksës.

Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr.04/L-110, konform Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022 ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejës Ndërtimore për ndërtimin e objektit, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MMPHI-së në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis – Komuna Suharekë

Numri i vrojtimit i lejes 07Nr.727/350-17527 datë: 15.09.2023

Vendimi i dërgohet: Parashtruesit të kërkesës; Inspektoratit të Komunës; Dosjes së DUMP-së

Drejtori i Drejtorisë:
Visar KUÇI